

VENDIM
Nr. 85, datë 10.2.2021

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 597, DATË 4.9.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE
PËRDORIMIT TË FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR
NDIHMËN EKONOMIKE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 8, të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 14, të kreut III, të vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 15, me këtë përmbajtje:

"15. Për përfituesit e ndihmës ekonomike, të përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d", të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, masa e ndihmës ekonomike dyfishohet për një periudhë 6-mujore, me qëllim zbutjen e efekteve të shkaktuara nga epidemia COVID-19."

2. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe